



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas/Gllogoc
Opština Glogovac / Municipality of Gllogoc



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore/ Jedinica za Single Resource Manager

Bazuar në nenin 77,78,79,80,81,82 dhe nenin 83 të Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtaret Publikë, nenin 8 të Ligjit nr.03/L-212 të Punës, neni 35 i Ligjit nr.04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 5 pika D e Ligjit nr. 03/I-068 për Arsimin në Komunitetë e Republikës së Kosovës, nenit 8, 13 dhe 16 të Rregullores (QRK) 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve të Institucioneve Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, NJMBNJ shpallë:

KONKURS

(I jashtëm)

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

Titulli i Vendit të punës: Drejtor në SHML " G.J.K.Skënderbeu" në Drenas

Numri i references: RN00016790

Institucioni: Komuna e Drenasit/Gllogocit

Drejtoria: Drejtoria për Arsim

Koficienti/paga: E13_CD-209

Afati i aplikimit: 21.02.2025 deri 22.03.2025

Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat në të njëtin Institucion Shkollor.

Periudha provuese: 9.6 muaj

1.Detyrat dhe përgjegjësitë: Drejtorit

1. Menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- 2.Hartimin e planit vjetor të punës dhe planit zhvillimor të institucionit,të cilin e miraton Këshilli drejtues i shkollës;
- 3.Kordinimin dhe bashkëpunimin me aktivet profesionale për ndarjen e normave dhe orëve për mësimdhënës/edukatorë, caktimin e kujdestarëve të klasave, kujdestarëve të dites si dhe kërkon raportim prej tyre;
- 4.Caktimin e detyrave për zgjedhjen, vlerësimin, disiplinën dhe çështjet të tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë edukativo-arsimor, konform legjislacionit në fuqi si dhe caktimi dhe shqiptimi i masave ndaj nxënësve,
- 5.Mentorimin dhe monitorimin e orëve mësimore si dhe vlërsimin e performancës së mësimdhënësve dhe stafit tjetër administrativ-teknik,në mënyrë objektive, për çdo vit shkollor, duke e vendosur një kopje të këtij vlerësimi në dosjen e secilit punëtor dhe përgadit një raport të përgjithshëm me rekomandime për DKA-në;
- 6.Pjesëmarrjen në panelin për pranimin e kuadrit në shkollë;
- 7.Nxjerrjen e vendimeve për themelimin e komisioneve të ndryshme në interes të shkollës;
- 8.Kryerjen e detyrave tjera të ngarkuara nga ana e DKA-së dhe obligimet e përcaktuara me akte tjera normative.

2.Kushtet që duhet t'i plotësojnë kandidatët për të marrë pjesë në konkurs

- 1.Kandidatët e interesuar për të konkurruar për drejtor/eshë dhe zëvendësdrejtor/eshë të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese parauniversitare (në vijim: IEAA-AP) duhet t'i plotësojnë këto kritere:
 - 1.1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Të ketë zotësi të plotë veprimi, sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.3. Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
 - 1.4. Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
 - 1.5. Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
 - 1.6. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndëne institucion publik;
 - 1.7. Të ketë të kryer arsimin universitar, nivelet e kualifikimit që i plotësojnë kushtet sipas normativit profesional për arsim të përgjithshëm dhe normativit për arsim profesional në fuqi;
 - 1.8. Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (kualifikimin prej 300 ECTS, së paku 5 vite të shkollimit universitar);
 - 1.9. Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar);
 - 1.10. Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
 - 1.11.Të ketë licencë të rregullt të mësimdhënësit/ses sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësve;
 - 1.12. Të ketë përfunduar me sukses një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI;
 - 1.13. Të ketë të paktën pesë (5) vite përvojë pune si mësimdhënës/e në IEAA-AP.

- 1.14. Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në legjislacioni në fuqi
2. Përjashtimisht paragrafit 1.1. shtetasit e huaj mund të aplikojnë kur kjo lejohet sipas legjislacioni në fuqi për zyrtarët publik.
3. Për shkollat profesionale të AAP dhe Qendrat e Kompetencës, kandidati/ja duhet të jetë me përgatitje profesionale sipas normativit për IAAP dhe profileve përkatëse të institucionit ku konkurron.

3. Në momentin e aplikimit, kandidatët duhet të posedojnë këto dokumente:

- 4.1. Diplomën e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit sipas pikave 1.7, 1.8, 1.9 apo 1.10 sipas pikës 2 të këtij konkursi;
- 4.2. Certifikatën për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të ofruar nga një institucion publik i aprovuar nga MASHTI;
- 4.3. Nëse kandidati/ja ka të përfunduar programin universitar Master për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, nuk obligohet të dorëzoj dëshminë/certifikatën e trajnimit për udhëheqje në arsim sipas pikës 1.12 të këtij neni;
- 4.4. Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- 4.5. Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore;
- 4.6. Dëshminë se nuk është i dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje;
- 4.7. Vërtetimin e përvojës së punës në procesin edukativo-arsimor, nëse aplikuesi ka përvojë pune;
- 4.8. Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike;
- 4.9. Portfolion profesionale me dëshmi.
5. Për pozitat e drejtorëve të shkollave, kandidatët dorëzojnë konceptin e një plani zhvillimor të shkollës, i cili përshkruan konkretisht mënyrën dhe strategjinë përmes së cilës do të përmirësohet cilësia menaxheriale e shkollës, mësimdhënia dhe rezultatet e nxënësve të shkollës.

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

- Testi më shkrim (deri 50 %)
- Intervista me gojë (deri 30 %)
- Vlerësimi i jetëshkrimit (Portofolio profesionale (deri 20 %)

Procedurat e konkurimit:

Konkurimi është i hapur për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës pa dallim, të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit, dispozitat e Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrat Publike, Rregullores (QRK) nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve, mësimdhënësve, bashkpunëtorëve profesional, asistentëve, instrukturëve dhe Sekretarëve në institucioneve publike edukativo-arsimore dhe aftësuese (IEAA) të arsimit parauniversitar Udhëzimit Administrativ të MASHTI, nr. 05/2021 si dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

Informata të përgjithshme:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në Zyrën për Shërbim me Qytetarë, nga ora 08:16 çdo ditë pune, në sportelet 10,11,12 në Komunën e Drenasit, aplikacionet mund të shkarkohen edhe nga web-faqja <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranojnë, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen përmes (e-mail) ose në mungesë të një konfirmimi përmes email nga kandidati, ata do të njoftohen me telefon dhe janë të detyruar të sjellin me vete dokumentet origjinale/noterizuara të kualifikimit që i kanë kryer.

Në rast të mos dorëzimit të dokumentacionit origjinal/noterizuar, kandidatët do të përjashtohen nga procedura e rekrutimit.

Konkursi dhe rezultatet do të publikohen në faqen zyrtare të Komunës së Drenasit <https://kk.rks-gov.net/glllogoc/>.